

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 499/12 Prot

Tropoje, më 31.12.2020

VENDIM

Nr.167, datë 24.12.2020

**“PER MIRATIMIN E BUXHETIT DHE NUMRIT MAKSIMAL TE PUNONJESVE
TE BASHKISE TROPOJE PER VITIN 2021,SI VITI I PARE I PBA-SE 2021-2023”**

Këshilli Bashkise Tropoje në mbledhjen e tij të dt.24.12.2020 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, neni 41 pika 1 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, nenin 37 të ligjit nr.68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, udhezimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NjQV” , udhezimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 10 date 27.02.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” dhe shtojcat plotesuese, udhëzimit plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023 ” si dhe shkresa nr.19697 dt 20.10.2020 dergim transferte e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale per vitin 2021 .Ju paraqet projekt-vendimin per miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal te punonjesve te Bashkise Tropoje.


VENDOSI:

1. -Te Miratoje Buxhetin dhe numrin e pergjithshem te punonjesve te Bashkise Tropoje sipas tabelës B2”struktura organizative” pasqyruar ne instrumentin e planifikimit financiar per vitin 2021,si viti i pare PBA-se 2021-2023


2. Te miratoje burimet financiare te Bashkise Tropoje sipas tabelës E1 "Vleresimi i burimeve" pasqyruar ne instrumentin e planifikimit financiar si dhe tabelës ndihmese nr.1. per vitin 2021 si viti i pare i PBA –se,2021-2023 si me poshte.
3. Te miratoje shperndarjen e burimeve financiare per vitin 2021,sipas programeve dhe funksioneve,sipas tabelës D1 "Tavane"pasqyruar ne instrumentin e planifikimit financiar per vitin 2021 si viti i pare i PBA-SE2021-2023 si me poshte ne mije /leke
 - Totali i pagave dhe sigurimeve shoqerore 206452 ✓
 - Totali shpenzimeve korente 32638
 - totali shpenzimeve kapitale 101873
 - Totali i tavaneve te pergjithshme 340963 mije /leke
4. Te beje miratimin e grafikut te detyrimeve te prapambetura sipas tabelës nr.2 Mbeshtetur ne udhezimin nr.37.dt.06.10.2020.
5. Te miratoje fondin rezerve dhe kontigjences,sipas tabelës D "tavanet sipas tabelës ndihmese nr.3 per vitin 2021 si viti i pare i PBA-se 2021-2023 ne shumen 10654 mije/leke
6. Te miratoje transferten specifike 2.3%per mbrojtjen civile ne shumen 2993 mije leke sipas shkreses nr.19697 dt 20.10.2020
7. Te miratoje 1.7 % sipas udhezimit udhezimit MFE NR.10.DT.28.02.2020 dhe MFE nr.27 dt.10.07.2020 ne shumen 3535 mije leke per mbrojtjen civile.
8. Vendimi hyn ne fuqi ,10 dite pas publikimit.

Per Bashkine Tropoje

Sekretari
Ergent Gjongecaj



Kryetari
Shote Bashaj



Verditë = Per tu plotësuar nga Departamenti i Financës

(B2) STRUKTURA ORGANIZATIVE

Numër	Emri i Nënfunksionit	Drejtoria / Departamenti	Kryetari i programit	Numri i punonjësve			
				Viti aktual	Viti t+1 (i parafundit)	Viti t+2 (i parafundit)	Viti t+3 (i parafundit)
Nënfunksioni 1	011 Organet ekzekutive dhe legislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme	DREJTORIA E KABINETIT	Bujar Hasanpajaj	100	100	100	100
Nënfunksioni 2	017 Shërbime të huamarrjes vendore		Kujtim Rexhaj				
Nënfunksioni 3	031 Shërbimet Policore						
Nënfunksioni 4	032 Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit		Kujtim Rexhaj	17	17	17	17
Nënfunksioni 5	036 Marrëdhëniet me komunitetin						
Nënfunksioni 6	041 Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregëtare dhe të punës		Bashkim Tafaj	27	27	27	27
Nënfunksioni 7	042 Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia		Kujtim Rexhaj	17	17	20	20
Nënfunksioni 8	045 Transporti						
Nënfunksioni 9	047 Industri të tjera						
Nënfunksioni 10	051 Menaxhimi i imbetëve						
Nënfunksioni 11	052 Menaxhimi i ujërave të zeza						
Nënfunksioni 12	053 Reduktimi i ndodhës						
Nënfunksioni 13	056 Mbrojtja e mjedisit						
Nënfunksioni 14	061 Urbanistika						
Nënfunksioni 15	062 Zhvillimi i komunitetit		Kujtim Rexhaj	91	91	91	91
Nënfunksioni 16	063 Furnizimi me ujë						
Nënfunksioni 17	064 Ndërtimi i rrugëve						
Nënfunksioni 18	072 Shërbimet e kujdesit parësor						
Nënfunksioni 19	081 Shërbimet rekreative dhe sportive		Abedin Kernaja	4	4	4	4
Nënfunksioni 20	082 Shërbimet kulturore		Abedin Kernaja	6	6	6	6
Nënfunksioni 21	091 Arsimi bazë dhe parashkollor		Abedin Kernaja	84	84	84	84
Nënfunksioni 22	092 Arsimi parauniversitar		Abedin Kernaja				
Nënfunksioni 23	101 Shëndytje dhe paafësi						
Nënfunksioni 24	102 Të moshuarit						
Nënfunksioni 25	104 Familje dhe fëmijë			6	6	6	6
Nënfunksioni 26	105 Pajuesia						
Nënfunksioni 27	106 Strehimi social						
				352	352	355	355



1. Buxheti i Bashkisë Tropoje është i mbështetur në burimet e financimit si më poshtë:

- I – Transferta e pakushtëzuar planifikuar për vitin 2021
- II- Të ardhurat nga taksat vendore planifikuar për vitin 2021
- III- Transferta e pakushtëzuar sektoriale planifikuar për vitin 2021
- IV Transferte specifike planifikuar 2021

BURIMET E FINANCIMIT PËR TË CILAT MERR VENDIM KËSHILLI


NR	Burimet Financiare për vitin 2021	Leke
1	Transferte e pakushtëzuar për vitin 2021	207974000
2	Transferte pakushtëzuar sektoriale per funksionet e deleguara per vitin 2021	92178000
3	Ardhura të planifikuara për vitin 2021	55000000
4	Transferte specifike 2021	2993000
5	Totali buxhetit 2021	358145000
6	Fond kontigjences per vitin 2021	3551520
7	Fondi Rezerve per vitin 2021	7103040
8	Fondi 1.7%	3535000
9	Transferte specifike 2021 emergjence civile	2993000
10	Totali rezerves kontigjences dhe emergjences	17182000
	Buxheti	340963000

Në mbështetje të ligjin Nr. 9936, dt 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit për buxhetin e vitit 2020, bëhet publike Transferta pakushtëzuar sektoriale për funksionet e Arsimit Parashkollor, Arsimit parauniversitar Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH), Administrimi I pyjeve, Ujitja dhe Kullimi, Rrugët.





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA TROPOJE



Parashikimi i të Ardhurave për periudhën 2021-2023

[Handwritten signature]

000/leke

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatumore	Fakti		Parashikimi		Parashik.		Parashik.	
		2018	2019	2020	2021	2022	2023		
I.	Te Ardhura nga Taksat								
1	Taksa mbi ndertesen	26,352	27,409	24,671	33,811	34,042	34,222		
2	Taksa mbi Truallin	2,999	1,677	3,254	3,254	3,254	3,254		
3	Taksa mbi Token Bujqesore	401	258	449	950	955	1,000		
4	Taksa e fjetjes ne hotel	227	261	2,188	2,188	2,188	2,188		
5	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	959	999	1,850	1,650	1,655	2,188		
6	Taksa mbi kalimin e te drejtes se proneseise per pasurite e palujtshme	13,376	13,381	5,250	14,700	13,505	13,665		
7	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	0	0	110	110	115	120		
9	Taksa e tabelës	5,522	8,430	8,455	8,400	8,450	8,450		
10	Takse e perkohshme(tregu)	42	40	40	75	80	80		
11	Taksa e rentes minerare	0	0	0	150	175	180		
12	Takse Reklamme	70	650	650	334	395	400		
13	Taksa te tjera	1,495	987	1,110	1,485	1,550	1,655		
14	Taksa mbi pasurin e palujtshme	471	0	515	515	520	525		
15	Tatim I thjeshtuar fitimi	0	0	0	0	0	0		
II.1	Te Ardhura nga Tarifat Vendore	790	726	800	0	1,200	1,205		
2	Te ardhura nga sherbimet publike nga institucione	13,321	11,102	11,259	12,225	12,292	12,500		
3	Te ardhura nga sherbimet publike nga biznesi	1,218	1,101	1,000	1,000	1,000	1,005		
4	Te ardhura nga sherbimet publike nga familje	10,565	8,829	9,100	8,051	8,292	8,350		
III.	Te Ardhura nga Tarifat per sherbime Administrative te bashkise	1,538	1,172	1,159	3,174	3,000	3,050		
1	Tarife nga vertetimet	2,260	1,727	8,800	4,218	4,180	4,173		
2	Tarifenga therje bagetie	393	133	130	1,000	960	960		
3	Tarife per licensimin e veprimtarive te transportit, autorizimee	30	0	100	120	120	100		
4	Tarife parkimi	858	565	7,000	1,000	1,000	1,005		
5	Tarife per Sektorin e pyje kullotave	501	455	1,000	398	400	403		
6	Tarife per sherbimin ne institucione e arsimit, kultures e sportit.	478	574	570	1,700	1,700	1,700		
7	Tarifa nga pallati kultures	2,559	3,047	2,650	2,665	2,700	2,725		
8	Tarifa nga Pallati I sportit	0	0	100	75	80	85		
9	Tarifa nga koopshet	0	0	100	75	80	85		
		1,330	1,227	1,250	1,300	1,305	1,305		

10	Tarifa nga Cerdhet	332	159	400	405	410	412
11	Zenitë Hapësira Publike	314	216	300	305	310	310
12	Te Ardhura te tjera	583	1,445	500	505	510	523
IV.	Gjohat	1,171	528	520	1,150	1,255	1,255
V	Te Ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera	4,606	7,124	7,100	1,511	1,531	2,125
1	Te ardhura nga dhënia me qera e aseteve ne pronesi te bashkise	4,606	7,124	7,100	1,511	1,531	2,125
2	Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme te trupëzuar	0	0	0	0	0	0
3	Shitje te pronave te ndryshme	0	0	0	0	0	0
4	Qera troje	0	0	0	0	0	0
5	Qera nga ndertesat	0	0	0	0	0	0
6	Interesa nga te ardhurat	0	0	0	0	0	0
VI	Te ardhura nga ndermarjet e ndryshme	0	0	0	0	0	0
VII	TA ARDHURAT	50,269	50,937	55,000	55,580	56,000	57,000





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE

**Buxheti i vitit 2021 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 ne nivel programi, per
Bashkine Tropoje**

I. Tavanet përfundimtare tëshpenzimeve per vitin 2021 si viti I pare i PBA për Vitet

2021-2023

Percaktimi i taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA për vitet 2021-2023, është realizuar bazuar në nenin 9, 34 dhe 41 të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, nenin 37 të ligjit 68/2017 datë 27.4.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NjQV", udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 10 datë 28.02.2020 "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023" dhe shtojcat plotësuese (Shtojcat e programit buxhetor afatmesem 2021-2023 nga 1-5 si informacion mbi nivelin e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, formati I pergatitjes se relacionit shoqerues se programit buxhetor afatmesem 2021-2023 formati per treguesit orientues te performances per cdo program, Grupi per menaxhimin Strategjik / Ekipi I Menaxhimit te programit si dhe roli I tyre, treguesit makroekonomik e fiskale, pema e programit si dhe Instrumenti I planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore), me shkresë hyrëse në Bashkinë nr prot. 4491/1 datë 04.03.2019, udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 27 datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023" me shtojcat perkatese 1-5, derguar e plote me e-mail date 15.07.2020 nga MFE, VKB nr. 27 date 30.12.2019 "Per miratimin e kalendarit te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem 2021-2023 dhe buxhetit vjetor 2021 te Bashkise Tropoje", shkresen nr. 4983 date 20.3.2020 drejtuar Keshillit Bashkiak per shqyrtim dhe miratim te projekt vendimit "Per tavanet pergatitore te shpenzimeve te Programit Buxhetor Afatmesem 2021-2023 te Bashkise Tropoje", shkresen nr. 7390 date 01.06.2020 drejtuar Keshillit Bashkiak per shqyrtim dhe miratim te projekt vendimit "Per miratimin e projektit te pare te Programit Buxhetor Afatmesem 2021-2023 te Bashkise Tropoje", shkresës drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 7401, datë 01.06.2020 "Dërgim materiale të projektit të parë të Programit Buxhetor Afatmesem 2021-2023 për Bashkinë".



Të gjitha materialet janë të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Tropoje.

Puna ka filluar, duke përcaktuar veprimtarinë e punës të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), si me poshtë vijon:

- Propozimin e strukturës së programeve duke siguruar përfshirjen brenda një programi shpenzimesh të funksioneve kryesore të njësisë.
- Shpërndarjen tek çdo Ekip i Menaxhimit të Programit të udhëzimeve të brendshme të nënshkruara nga titullari në lidhje me zbatimin e procedurave të programit buxhetor afatmesëm.
- Diskutimin me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t'u diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Nënshkrimin e të gjithë raporteve të përgatitjes së kërkesave buxhetore për përdorim të brendshëm të njesisë në lidhje me Rishikimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.
- Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kërkesave buxhetore.

II. Burimet e Financimit

Ne baze teudhezimit plotesues nr. 27 date 10.07.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” si dhe vendimit te Keshillit Bashkiak **nr. 11 date 26.2.2020** me objekt “ Per miratimin e raportit te vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te Bashkise Tropoje per vitet 2021-2023” burimet e financimit per PBA 2021-2023 jane si me poshte:

(000/lekë)

Nr.	Burimet e financimit	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
1	Transferte e pakushtezuar	207974	212 298	228 282
2	Të ardhurat e veta vendore	55 000	56 000	57 000
3	Grante dhe ndihma nderkombetare			
4	Transferta pakushtezuar sektoriale	92178	89 844	89 844
5	Transferta specifike	2993		
TOTALI				
6	Te trasheguara			
TOTALI&TRASHEGUARA				

II.2.1 Te Ardhurat e Veta.

Keshilli Bashkiak me vendimi nr. 11 date 26.2.2020 me objekt “ Per miratimin e raportit te vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te Bashkise Tropoje per vitet 2021-2023” ka miratuar te ardhurat e planifikuara si me poshte :

Adresa: Azem Hajdari ,B.Curri ,Tropoje Tel 0213-22-873,email bashkiatropoj@gmail.com



(000/lekë)

Vitet	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Te ardhurat e veta Grante dhe ndihma nderkombetare	55 000	56 000	57 000

II.2.2 Transferta e pakushtezuar.

Ne baze te udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise ndarja e transfertes së pakushtezuar sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për periudhën 2021-2023, bazohet në formulë, sipas përcaktimeve të nenit 24 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Të dhënat sipas kriterit të popullsisë, të dëndësisë së popullsisë, të numrit të nxënësve, taksat e përdorura për ekualizimin janë ato të përdorura në ndarjen e transfertes së pakushtezuar në buxhetin e vitit 2020. Sipas udhezimitplotesues nr. 27 date 10.07.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” me shtojcat perkatese 1-5 , per Bashkine Tropoje transferta e pakushtezuar eshte parashikuar si me poshte :

(000/lekë)

Vitet	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Transferte e pakushtezuar	207974	212 298	228 282

Sqarojme se sipas udhezimit plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023 ” transferta e pakushtezuar per vitin 2021 eshte 0.0449% me e ulet se transferta e pakushtezuar e akorduar per vitin 2020 ne kundershtim me nenin 23 pika 3 te ligjit 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore” qe thote: “Në çdo rast, transferta e pakushtezuar nuk mund të jetë më e vogël se shumata totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor”.

Kemi ndryshim te tavaneve perfundimtare te PBA 2021-2023 sepse kemi rnie te transfertes se pakushtezuar vetem per vitin e pare te tre vitet e PBA 2021-2023 per kete faze kundrejt transfertes se pakushtezuar te njoftuar me udhezimin nr. 10 date 28.02.2020“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023” , konkretisht kemi rnie te transfertes se pakushtezuar per vitin 2021 me 0.0499%, kemi rritje per vitin 2022 me 0.2% rritje per vitin 2023 me 0.09%.

Per te mbuluar diferencen e transfertes se pakushtezuar te planifikuar me pak per vitin 2021 me udhezimin plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023 ” dhe per te ruajtur nivelet e tavaneve perqatitore te paraqitura per miratim me shkresen nr. 4983 date 20.3.2020 dhe shkresen nr. 7390 date 01.06.2020 drejtuar Keshillit Bashkiak kemi perdorur fondet e trasheguara nga viti 2019 te miratuar me VKB nr.19 datë 23.04.2020 “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2019 të Bashkisë Tropoje” me burim financimi nga transferta e pakushtezuar, transferta e pakushtezuar sektoriale dhe te ardhurat ne shumen 51 099 mije leke .



II.2.3 Transferta e pakushtezuar sektoriale

Sipas udhezimit transferta pakushtezuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor për periudhën 2021-2023, bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar.

Ndarja e transfertës pakushtezuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2021-2023 do të si me poshte.

(000/lekë)

Transferta e Pakushtezuar Sektoriale	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Konviktet e arsimit parauniversitar			
Arsimi parauniversitar	3595	3 490	3 490
Arsimi parashkollor	48770	48 338	48 338
Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	15146	14 705	14 705
Mbrojtja Sociale			
Administrimi i pyjeve	13152	11 957	11 957
Rrugët rurale	8 646	8 646	8 646
Ujitja dhe Kullimi	2869	2 709	2 709
TOTALI	92178	89 844	89 844

II.2.4 Transferta e kushtezuar.

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Biznesit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë, për Përsosjen me Aftësi të Kufizuar, .

Struktura e punonjesve te gjendjes civile eshte sipas VKM nr 1299, date 16.12.2009, me 9 punonjes, ku mbulohen 8 zyra te gjendjes civile, te shperndara ne qytet dhe NJA (ish komuna). Paguesa e punonjesve behet ne perputhje me Vendim i KM, Nr.187, Dt.08.03.2017.

Struktura e punonjesve te shërbimit te QKB-se ne bashki eshte ne perputhje me numrin e sporteleve te hapura prane njesive te vetqeverisjes vendore 2 punonjes. Kjo ne zbatim te nenit 11 te ligjit nr 9723, date 03.05.2007” Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” te ndryshuar.

Peshen me te madhe te shpenzimeve qe mbulohen me transferte te kushtezuar e zene transferimet individuale per pagese përsonat me aftësi të kufizuar , invaliditeti dhe ndihme ekonomike dhe konkretisht per vitin 2021 ne shumen 340 000 mije leke , ne vitin 2022 ne shumen 370 000 mije leke dhe ne vitin 2023 ne shumen 390 000 mije leke. Pra mesatarisht95% te transfertes se kushtezuar.

Meqenese ne udhezimin e MFE nr. 10 date 28.2.2020 dhe udhezimin e MFE nr.27 date 10.07.2020 , nuk ka instruksione specifike per llogaritjen e 1.7% % tefondeve per mbrojtjen civile,Në transfertën e kushtëzuar është përfshirë llogaritja prej 2.3% , bazuar ne shkresen e Ministrise se Financave dhe Ekonomise per buxhetin e vitit 2021, nr e 19697, date 20.10.2020. Fondet janë parashikuar nëprogramin04970. Ne Shumen 2.993 mije leke. Transferte specifike.



Vitet	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023
Transferta e kushtëzuar	340 000	370 000	390 000

III. Programet dhe Tavanet

Sipas udhëzimit Plotesues nr.10 date 28.02.2020“ *Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023*” dhe shtojcat bashkangjitur ketij udhezimi si dhe udhezimit plotesues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 “*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2021-2023* ” me shtojcat perkatese 1-5, struktura e programeve te buxhetit vendor Tropojedo tëjete si më poshtë:

Nr	Funksioni	Nr	Nenfunksioni	Nr	Programi
1	SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE	011	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	01110	Planifikim menaxhim administrim
				01170	Gjendja civile
		032	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
		042	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia		
				04240	Menaxhimi i infrastructures se ujitjes dhe kullimit
				04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave
		045	Transporti	04520	Rrjeti rrugor rural
5	MBROJTJA E MJEDISIT	051	Menaxhimi i mbetjeve	05100	Menaxhimi i mbetjeve
		052	Menaxhimi i ujërave të zeza	05200	Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve
		053	Reduktimi i ndotjes	05320	Programet e mbrojtjes se mjedisit
		062	Zhvillimi i komunitetit	06260	Sherbimet publike vendore
		063	Furnizimi me ujë	06330	Furnizimi me uje
8	ARGETIMI KULTURA DHE FEJA	081	Shërbimet rekreative dhe sportive	08140	Sport dhe argetim
		082	Shërbimet kulturore	08250	Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
9	ARSIMI	091	Arsimi parashkollor dhe bazë	09120	Arsimi bazë perfshire arsimin parashkollor
		092	Arsimi parauniversitar	09230	Arsimi i mesem i pergjithshem



				09240	Arsimi profesional
10	MBROJTJA SOCIALE	104	Familje dhe fëmijët	10430	Kujdesi social per familjet dhe femijet
		105	Papunësia	10550	Papunësia, arsim dhe aftësim
		106	Strehimi	10661	Strehimi social

FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Nënfunkcioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Vështrim i përgjithshëm		
<p>Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;</p>		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i programit
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin; Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësi, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj. Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë. Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit;
01170	Gjendja Civile	<ul style="list-style-type: none"> Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Adresa: Azem Hajdari ,B. Curri , Tropoje Tel 0213-22-373, email bashkiatropoje@gmail.com



Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
0110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	56108	14621		70729	58000	14621	72621	145242	60000	20000	80000	160000
01170	Gjendja civile												

FUNKSIONI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
03140	Shërbimet e Policisë Vendore												

Nënfunkcioni 032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri

Vështrim i përgjithshëm

Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i programit
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	<ul style="list-style-type: none"> Funksionimi i njërive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj.

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore

Adresa: Azem Hajdari ,B.Curri , Tropoje Tel 0213-22-373, email bashkiatropoj@gmail.com



Signature

032	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	13000	2146	0	15146	13000	1705	0	14705	13000	1705	0	14705
-----	---	-------	------	---	-------	-------	------	---	-------	-------	------	---	-------

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

Nënfunkcioni 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	<ul style="list-style-type: none"> Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistikapër çështjet dhe shërbimet bujqësore; Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë; Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë; Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural. Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit. Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës;
04240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla; Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësisë të vetëqeverisjes vendore.
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	<ul style="list-style-type: none"> Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; Konservim, zgjerim dhe shfrytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore; Administrim i fondit pyjor dhe kullor publik;

Adresa: Azem Hajdari ,B.Curri ,Tropoje Tel 0213-22-373, email bashkiatropoj@gmail.com



[Handwritten signature]

		<ul style="list-style-type: none"> Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh. Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimin shërbimeve për operatorët pyjorë; Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore; Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes;
--	--	--

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mijë lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
042 40	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	1900	969	3286	6155	1900	809	0	2709	1900	809	0	2709
042 60	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	11195	1957	0	13152	10000	1957	0	11957	10000	1957	0	11957

Nënfunkcioni 045: Transporti

Vështrim i përgjithshëm

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugorbrenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
04520	Rrjeti rrugor rural	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore; Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe



		kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;
--	--	--

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
04520	Rrjeti rrugor rural	6900	1746	98687	107333	6900	1746	108653	117299	6900	1746	117749	126395

Në mije lekë

Nënfunksioni 062: Zhvillimi i komunitetit

Vështrim i përgjithshëm		
Veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
06260	Shërbimet publike vendore	<ul style="list-style-type: none"> Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapsirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapsirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
06260	Shërbime publike vendore	52626	7000		59626	53000	7000	60000	120000	53000	7000	60000	120000

Adresa: Azem Hajdari, B. Curri, Tropoje Tel 0213-22-373, email bashkiatropoje@gmail.com



Handwritten signature

Nënfunkcioni 063: Furnizimi me ujë


Vështrim i përgjithshëm		
Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
06330	Furnizimi me ujë	<ul style="list-style-type: none">• Administrim i problemeve të furnizimit me ujë;• Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë;• Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë;• Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë;• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë.

FUNKSIONI8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

Nënfunkcioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive

Vështrim i përgjithshëm		
Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
08140	Sport dhe argëtim	<ul style="list-style-type: none">• Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapimi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj.); mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive; Mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive (struktura për qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.);• Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe apo lojtarë individualë.• Vënie në funksionim ose mbështetje për ambiente që përdoren për veprimtari çlodhëse (parqe, plazhe, kampingje dhe vendqëndrimet përkatëse) të ofruara në bazë jotregtare;

Adresa: Azem Hajdari ,B. Curri , Tropoje Tel 0213-22-373, email bashkiatropoj@gmail.com



Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrent e	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzim eve Buxhetor e	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrent e	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzim eve Buxhetor e	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrent e	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzim eve Buxhetor e
08140	Sport dhe argëtim	3319	1104	0	4423	3400	0	0	3400	3400	0	0	3400

Nënfunkioni 082: Shërbime kulturore

Vështrim i përgjithshëm		
Organizim, mbështetje e ngjarjeve kulturore në njësinë e vetëqeverisjes vendore; mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
08250	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike; Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e të ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytatar; Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave; Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerts, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.); Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore; Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokale.

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrent e	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzim eve Buxhetor e	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrent e	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzim eve Buxhetor e	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrent e	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzim eve Buxhetor e
08250	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	7381	0		7381	7400	0	0	7400	7400	0	0	7400



FUNKSIONI9: ARSIMI

Nënfunkcioni 091: Arsimi parashkollor dhe bazë

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështetja e arsimit bazë dhe parashkollor Administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	<ul style="list-style-type: none">• Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës;• Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve;• Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve.• Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore;

Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mije lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital e	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	46600	2170	0	48770	46600	1738	0	48338	46600	1738	0	48338

Nënfunkcioni 092: Arsimi parauniversitar

Vështrim i përgjithshëm		
Mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore;• Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.• Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.• Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave;• Mbështetje për trajnimin e mëtjejshtëm të mësuesve.



Tavanet per PBA 2021-2023 jane si me poshte :

Në mijë lekë

Nr.	Emertimi i PROGRAMIT	2021				2022				2023			
		Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Paga dhe Siguri me shoqerore	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapital	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	3595	0	0	3595	3490	0	0	3490	3490	0	0	3490

FUNKSIONI10: MBROJTJA SOCIALE

Nënfunkcioni 102: Familjet

Nënfunkcioni 104: Familja dhe fëmijët

Vështrim i përgjithshëm		
